



AKT THEMELIMI

**I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANËS" Sh. P.K.**

Sot më 09/09/2009, para meje noteres Hayan Noaj u paraqitën personalisht :

1. Z. LUAN MEMUSHI, shtetas shqiptar, lindur më 11.11.1951 në Tepelenë dhe banuese në Tiranë – Rruga "Komuna e Parisit", Pallati 3/1 VJERO, Shkalla 1, Ap. 19, mbajtëse e pasaportës me Nr. D0000458;

person madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u binda nga dokumentet identifikuese që më paraqiti. Ai me vullnetin e tij të plotë e të lirë, nënshkroi në praninë time Aktin e Themelimit të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANËS" Sh. P.K., si poshtë vijon :

Neni 1. Themelimi

1. Z. LUAN MEMUSHI, shtetas shqiptar, lindur më 11.11.1951 në Tepelenë dhe banuese në Tiranë – Rruga "Komuna e Parisit", Pallati 3/1 VJERO, Shkalla 1, Ap. 19, mbajtës i pasaportës me Nr. D0000458, themelon një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin: "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANËS" Sh.p.k.

Neni 2. Ligjshmëria e veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, me Aktin e Themelimit dhe me Statutin e shoqërisë.

Neni 3. Objekti

Shoqëria ka për objekt të kryejë dhe të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet dhe bizneset që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të kryejë në bazë të legjislacionit shqiptar, të tilla, si :

1. Krijimi dhe menaxhimi i institucioneve arsimore për të gjitha nivelet dhe llojet;
2. Krijimi dhe menaxhimi i kurseve të trajnimit dhe kualifikimit arsimor e profesional për të gjitha nivelet dhe llojet;

1

3. Pjesëmarrja në projekte e studime që kanë për objekt fushat e veprimtarisë së shoqërisë;
4. Veprimtari botuese dhe shtypshkrimi.

Neni 4. Selia

Shoqëria e ka selinë e saj në Adresën: Rruga "Budi" nr. 74/1, (ish godina e NATO-s pranë Qytetit Studenti), Tiranë. Shoqëria mund të hapë filiale, degë dhe zyra përfaqësuese në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe / ose jashtë saj.

Neni 5. Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore mbi 10 vjeçare, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar.

Neni 6. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqind mijë lekë) dhe është i ndarë në 100 kuota të barabarta, vlera nominale e të cilave është 1000 (njëmijë) lekë. Kapitali është i zotëruar 100% nga Ortaku i Vetëm, Z. Luan MEMUSHI. Kapitali i mësipërm është i nënshkruar dhe derdhur tërësisht nga ortaku i vetëm i shoqërisë.

Neni 7. Administrimi

Administrator i shoqërisë është emëruar z. Luan MEMUSHI. Administratori ushtron funksion për një periudhë kohe 5 vjeçare që nga momenti i emërimit, me të drejtë riemërimi. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë. Administratori do të qëndrojë në detyrë deri në momentin e mandatit në rast mosrinovimi të tij apo me revokimin e mandatit nga Ortaku i Vetëm.

Neni 8. Përgjegjësia personale

Administratori është përgjegjës për administrimin e shoqërisë dhe përgjigjet penalisht përballë shoqërisë ose të tretëve për shkeljet e mundshme të ligjit dhe/ose të statusit.

Neni 9. Të drejta të administratorit

Administratorit i njihet e drejta t'u delegojë me prokurë personave të tretë të zgjedhur prej tij, të gjitha apo një pjesë të kompetencave që i janë dhënë atij sipas statutit dhe që i njihen nga legjislacioni shqiptar për veprimtaritë tregtare, pasi themeluesi i shoqërisë të ketë rënë dakord përmes një akti të caktuar ligjor.

Neni 10. Viti financiar

Viti financiar fillon më 01 Janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti, përjashtuar vitin e parë që fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin tregtar.

2

Neni 11. E drejta pronësore

Kur drejtimi dhe administrimi i shoqërisë bëhet i pamundur nga themeluesi i kësaj shoqërie, për shkak të bazuarit në ligj, e drejta e pronësisë dhe gjithë përgjegjësitë e të drejtat e tjera mbi shoqërinë dhe kapitalin e mallin e saj transferohen të plotë në të tjerët të familjes së themeluesit të shoqërisë.

2. Ky akt i themelimit të shoqërisë "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANËS" Sh.p.k. përpulohet në katër kopje në gjuhën shqipe, nënshkruhet rregullisht nga themeluesi i saj dhe unë noteri e vërtetoj sipas ligjit.

THEMELUESI

Luan Memushi
Rruga "Komuna e Parisit",
Pallati VJERO 3/1, Shk. 1,
Ap 19 - TIRANË

Cel. 00355682090099

Noteri



3